



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 tetor 2012  
Nr. ref.:MMP304/12

## MENDIMI KONKURRUES DHE MOSPAJTUES I GJYQTARIT ROBERT CAROLAN

në

**Rastin nr. KO61/12**

**Vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga  
Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012**

Më 22 qershor 2012, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, i përcolli Gjykatës Kushtetuese amendamentet vijuese të Kushtetutës, duke i kërkuar Gjykatës të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara, në ndonjë mënyrë, zvogëlojnë ndonjë nga të drejtat apo liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës:

### **Amendamentet e propozuara**

#### *Amendamenti 1 – Amnistia*

*Me amnisti do të lirohen nga ndjekja penale plotësisht apo pjesërisht, apo nga ekzekutimi i dënimit, personat që do të përcaktohen me emër, do t'u zëvendësohet dënimi duke iu dhënë dënim më të butë apo duke u bërë shlyerja nga evidenca e të dënuarve.*

*Kuvendi i Republikës së Kosovës për dhënien e Amnistisë nxjerr ligj përkatës.*

*Ligji për Amnistinë miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve.*

#### *Amendamenti 2 – Ndryshimi i nenit 108 - Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

*Neni 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndryshohen si në vijim:*

- (1) Shtatë (7) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit.*
- (2) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.*

## **Autoriteti i Kuvendit**

Autoriteti për ndryshimin e Kushtetutës i është dhënë vetëm Kuvendit, sipas nenit 65 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

*“Kuvendi i Republikës së Kosovës:*

- (1) Miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*
- (2) Vendos të ndryshojë Kushtetutën me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve, duke përfshirë dy të tretat (2/3) të të gjithë deputetëve që mbajnë ulëse të rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;*

## **Autoriteti i Gjykatës Kushtetuese**

Autoriteti i Gjykatës Kushtetuese rrjedh nga Kushtetuta, sepse:

- (1) Neni 16 i Kushtetutës në mënyrë specifike përcakton: “Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta”.*
- (2) Neni 4.6 i Kushtetutës përcakton që Gjykata Kushtetuese “... bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”.*

## **Autoriteti shqyrtues i Gjykatës**

Autoriteti i Gjykatës për lëshimin e një aktgjykimi si mendim këshillues në këtë çështje është i parashikuar me nenin 113.9 si dhe me nenin 144.3 të Kushtetutës.

Neni 113.9 përcakton që:

*Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.*

*(me theks të shtuar.)*

Neni 144.3 përcakton që:

*Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.*

*(me theks të shtuar.)*

Autoriteti i Gjykatës për të nxjerrë mendim për amendamentet e propozuara kushtetuese kufizohet vetëm te vlerësimi nëse ato pakësojnë ndonjë të drejtë apo liri të përcaktuar me Kapitullin II (nenet 21 -56) të Kushtetutës.

## **Amendamenti i propozuar 2 dhe pjesa e amendamentit 1**

Shumica vendosi që amendamenti i propozuar 2 nuk pakëson të drejtat apo liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Unë pajtohem me konkludimin e shumicës përkitazi me amendamentin e propozuar 2.

Shumica vendosi që pjesa vijuese e amendamentit të propozuar 1 nuk pakëson të drejtat apo liritë e përcaktuara me Kapitullin II:

*Kuvendi i Republikës së Kosovës për dhënie e Amnistisë nxjerr ligj përkatës.*

*Ligji për Amnistinë miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve.*

Unë pajtohem me konkludimin e shumicës që ky amendament i propozuar nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë apo liri të përcaktuar me Kapitullin II.

### **Fjalja e parë e amendamentit të propozuar 1**

Shumica vendosi që fjalja e parë e amendamentit të propozuar 1, si në vijim, shkel Kushtetutën:

*Me amnisti do të lirohen nga ndjekja penale plotësisht apo pjesërisht, apo nga ekzekutimi i dënimit, personat që do të përcaktohen me emër, do t'u zëvendësohet dënimi duke iu dhënë dënim më të butë apo duke u bërë shlyerja nga evidenca e të dënuarve*

Konkludimi i shumicës është edhe i gabueshëm, edhe i paautorizuar. Deri në masën që ai bazohet te neni 24 i Kushtetutës, konkludimi bazohet në një interpretim të gabueshëm të nenit 24. Deri në masën që konkludimi i shumicës bazohet në nenet e Kushtetutës jashtë Kapitullit II, apo parimeve të tjera juridike, vendëse apo të huaja, ky është koment i paautorizuar.

Shumica ofron arsyet që, pasi amendamenti i propozuar do të autorizonte një lloj organi shtetëror, supozohet Kuvendin, që të bënte faljen apo amnistinë e "... *personave të caktuar me emër ...*", kjo: (1) në fakt, nuk është dhënie e amnistisë, ashtu si përdoret ky term në shumë juridiksione në gjithë botën; (2) që kjo do të shkelte pushtetin kushtetues të Kryetarit të Republikës që të bëjë faljen sipas nenit 84(29) të Kushtetutës; si dhe, (3) që shkel autoritetin në nenin 65 të Kushtetutës përkitazi me autoritetin ligjvënës të Kuvendit. Shumica, më tutje, gjen që do të shkelte dispozitat e barazisë në nenin 24 të Kushtetutës, pasi që disa individë të caktuar me emër mund të fitojnë dhënien e amnistisë, derisa të tjerët nuk mund të përfitojnë atë.

Edhe nëse amendamenti i propozuar do të ishte shkelje e neneve të tjera të Kushtetutës jashtë Kapitullit II, ose edhe nëse amendamenti i propozuar provon të krijojë një mekanizëm të ri, apo mekanizëm tjetër ligjor që të jetë në fuqi në Kosovë, kjo Gjykatë nuk ka autoritetin, në këtë kohë, që të komentojë për ato aspekte të amendamentit të propozuar në kontekstin në të cilin është adresuar në Gjykatë, sepse shqyrtimi nga Gjykata, para miratimit, të amendamenteve të mundshme kushtetuese, kufizohet në vlerësimin nëse ato pakësojnë të drejtat apo liritë e Kapitullit II të Kushtetutës. Përveç brengave të shumicës përkitazi me të drejtat dhe liritë e përcaktuara me nenin 24 të Kushtetutës, kundërshtimet e theksuara nga shumica janë përtej fushëveprimit të Kapitullit II të Kushtetutës. Kështu, këto aspekte të vlerësimit janë të paautorizuara.

Përgjithësisht, shumë juridiksione në botë e konsiderojnë "amnistinë" si një akt sovran i faljes dhe i harresës për veprat e kaluara, që jepen nga qeveria për gjithë personat apo për grupet e caktuara të personave që janë shpallur fajtorë për një krim apo për ndonjë vepër politike. "Falja" dallohet nga dhënia e amnistisë, pasi falja vlen vetëm për një individ të veçantë, për veprën e tij apo të saj, por nuk prek kriminalitetin e veprave të njëjta apo të ngjashme kur kryhen nga personat e tjerë, apo kur përsëriten nga i njëjti person. "Amnistia" është përkufizimi i një akti mirësie, që jepet nga qeveria për gjithë personat që i përkasin asaj kategorie, si dhe i cili shlyen kriminalitetin e veprave të kaluara, si dhe shpall që ato nuk do të trajtohen më si të dënueshme. *Shih Black's Law Dictionary (Fjalori Juridik Black's), botimi i katërt, 108.*

Neni 24 i Kushtetutës [Barazia para ligjit] përcakton që:

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Ky nen flet për trajtimin e barabartë të të gjithë personave që janë në pozita të barabarta. Ai veçanërisht ndalon diskriminimin ndërmjet njerëzve në baza të racës, të ngjyrës, të gjinisë, të gjuhës, të fesë, të mendimit politik, apo të mendimeve të tjera, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të lidhjes me ndonjë komunitet, të pronës, të gjendjes ekonomike a sociale, të orientimit seksual, të lindjes, të aftësisë së kufizuar, ose të ndonjë statusi tjetër personal. Ky nen nuk kërkon që secili të trajtohet absolutisht si i barabartë, apo të fitojë kompensim plotësisht identik përderisa ka arsye racionale, jodiskriminuese, për trajtim të barabartë që dallon. Në fakt, paragrafi 3, i nenit 24, veçanërisht autorizon disa trajtime të pabarabarta për aq sa këto bëhen në baza racionale e jodiskriminuese.

Shumica gabimisht gjen që, për shkak se amendamenti i propozuar do të autorizonte një autoritet apo institucion qeverisës që të caktojë emrat e personave të caktuar për të fituar amnistinë, ky do të ishte trajtim i pabarabartë i personave të tjerë. Këtu lihet të nënkuptohet që, nëse do të miratohej ky amendament, Qeveria do ta aplikonte në mënyrë diskriminuese. Nuk ka prova për të mbështetur këtë konkludim, ashtu siç nuk ka prova të thuhet se autorizimi i faljes, i përcaktuar me nenin 84 (29) të Kushtetutës, shkel dispozitat e trajtimit të barabartë sipas nenit 24.

Në vlerësimin nëse ky amendament i propozuar do të ishte në shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, shumica konkludon që ai do të mundësonte një trajtim të palejueshëm ndryshe të personave, duke u bazuar te rasti D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, (GC), no 57325/00, 175 ECHR 2007. Ky bazim, gjithashtu, është i gabuar. Në atë rast, ndërmjet viteve 1996 dhe 1999, parashtruesit, të gjithë shtetas çekë me origjinë rome, ishin vendosur në "shkolla speciale", e jo në shkollat e rregullta fillore në Republikën Çeke. Ata ishin ankuar që kjo praktikë kishte shkelur nenin 14 të Konventës. Me hedhjen poshtë të ankesës së parashtruesve për shkeljen e nenit 14, Gjykata kishte theksuar që, sipas nenit 14, personat e ndryshëm mund të trajtohen ndryshe ndërmjet vete, për aq sa kjo bëhet në baza racionale e jo vetëm kundër personave me mbrojtje të veçantë sipas nenit 14. Gjykata vendosi që nuk kishte prova në argumentet e parashtruesve që kjo praktikë po aplikohet në mënyrë diskriminuese.

Ngjashëm, kjo Gjykatë nuk mund të supozojë që, nëse do të miratoheshin amendamentet e propozuara, ato do të aplikoheshin në një mënyrë që do të ishte në kundërshtim ose me nenin 14 të Kushtetutës, ose me nenin 24 të Kushtetutës. Nëse amendamenti miratohet, e pastaj aplikohet në mënyrë të paligjshme e diskriminuese, në shkelje të Kushtetutës, çdo palë e autorizuar pastaj do të mund të bënte padinë e saj në gjykatat përkatëse të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese.

Shumica gjithashtu gjen që amendamenti i propozuar do të ishte diskriminues e i paligjshëm, duke arsyetuar që nuk do të kishte arsyetim objektiv e racional, sepse nuk po përcillte një synim legjitim, apo nuk kishte ndërlidhje apo proporcionalitet të arsyeshëm ndërmjet mjeteve të përdorura dhe synimit që dëshirohet të arrihet. Është spekulative të theksohet që amendamentet e propozuara nuk kanë arsyetim objektiv e racional, apo synim legjitim.

Prandaj, konkludoj që të gjitha amendamentet e propozuara të Kushtetutës duket të jenë në përputhje me Kapitullin II (nenet 21 – 56) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe nuk do të zvogëlonin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me këto nene të Kushtetutës. Për shkak të kufizimeve në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës në lidhje me autoritetin e Gjykatës për të nxjerrë mendim këshillëdhënës përkitazi me amendamentet e propozuara në këtë kohë para se ato të miratohen dhe zbatohen unë nuk do të jap ndonjë mendim në lidhje me aspektet e tjera të amendamenteve të propozuara.

E paraqet me respekt,



**Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**